

1 E premte, 12 korrik 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Paraqitje e mëtejshme]

4 [Të akuzuarit Bahtijari dhe Januzi hyjnë në
5 sallën e gjyqit]

6 --- Seanca fillon në orën 09.30

7 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Mirëmëngjes dhe mirë se
8 keni ardhur të gjithë.

9 Përpara sesa të fillojmë, do të ftoja fotografen që të
10 futej në sallën e gjyqit dhe të bënte disa fotografi për një
11 minutë e gjysmë.

12 Është fotografia këtu?

13 Znj. Fotografe, ju lutem mund të bëni fotografi të sallës
14 së gjyqit dhe të pjesëmarrësve.

15 Faleminderit, znj. Fotografe.

16 Znj. Sekretare e seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
18 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2023-10, Prokurori i
19 Specializuar kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi
20 Shalës.

21 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, znj.

22 Sekretare.

23 Përpara sesa t'ju kërkoj personave që janë të pranishëm
24 në sallë që të prezantohen, më lejoni që t'ju kujtoj të
25 gjithëve disa rregulla të rëndësishme që do të duhet të

1 respektohen gjatë seancës.

2 Ju lutem sigurohuni që të ndizni mikrofonin përpara sesa
3 të flisni dhe ta fikni atë pasi të keni përfunduar së folur.
4 Po ashtu do ju kërkoja që të flisnit ngadalë dhe qartë sepse
5 kemi përkthim në gjuhën shqipe dhe nga gjuha shqipe, dhe në
6 gjuhën serbe dhe drejt gjuhës serbe. Po ashtu prisni pesë
7 sekonda përpara sesa t'i përgjigjeni pyetjeve që unë do të bëj
8 ose pyetjeve të një pale ose të një pjesëmarrësi.

9 Do të fillojmë me prezantimin me Zyrën e Prokurorit të
10 Specializuar.

11 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
12 Gjykatës. Nga Zyra e Prokurorit të Specializuar kemi
13 Prokuroren e Specializuar znj. Kimberly [Sipas përkthimit];
14 kemi gjithashtu edhe z. Joshua Hafetz; znj. Tazneen
15 Shahabuddin; dhe Line Pedersen, menaxhere e çështjes.

16 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Tani Mbrojtja e z.
17 Januzi.

18 Së pari do ju kërkoja gjithashtu që të prezantonit
19 klientin tuaj, Avokat.

20 Z. BOWDEN: [Përkthim] Përshëndetje, unë jam Hugh Bowden,
21 jam bashkëmbrojtës. Z. Jonathan Rees, po ashtu edhe avokati
22 tjetër i pranishëm këtu në sallën e gjyqi është edhe z.
23 Januzi.

24 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull.

25 Tani Mbrojtja e z. Bahtijari.

1 Ju lutem prezantohuni. Prezantohuni ju si ekip, dhe
2 gjithashtu klientin tuaj.

3 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Përshëndetje
4 të gjithëve, unë jam Felicity Gerry. Unë jam Avokatja e z.
5 Bahtijari, ndërkohë që z. Bahtijari është i pranishëm në
6 sallën e gjyqit.

7 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
8 Avokate.

9 Dhe së fundi do ja jap fjalën Zyrës Administrative.

10 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëmëngjes, e nderuar Gjykatëse.
11 Mirëmëngjes, të nderuar kolegë.

12 Unë jam Jonas Nilsson, jam Zëvendësadministrator, dhe
13 këtu jam përfaqësues i Zyrës Administrative të Gjykatës.

14 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Për procesverbal, unë jam
15 Marjorie Masselot, jam Gjykatëse e Procedurës Paraprake.

16 Përpara sesa të fillojmë, më lejoni të kujtoj se cilat
17 janë çështjet më të rëndësishme që duhet të diskutojmë sot.

18 Më 4 tetor 2023, Zyra e Prokurorisë së Specializuar
19 dorëzoi aktakuzën kundër z. Januzi, z. Bahtijari, sikurse
20 ishte konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,
21 përkatësisht, Aktakuza e Konfirmuar për Çështjen 10.

22 Më 6 nëntor 20023, Zyra e Prokurorit të Specializuar
23 dorëzoi aktakuzën kundër Haxhi Shalës sikurse ishte konfirmuar
24 nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, përkatësisht, Aktakuzën
25 e Konfirmuar për Çështjen 11.

1 Më 8 shkurt 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake
2 miratoi kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për të
3 bashkuar Çështjen e Prokurorit të Specializuar kundër z.
4 Januzi dhe z. Bahtijari, Çështja 10, me çështjen Prokurori i
5 Specializuar kundër z. Shala, Çështja 11. Gjykatësi i
6 Procedurës Paraprake po ashtu vendosi që çështja e përbashkët
7 do të vazhdonin mbi bazën e Aktakuzës së Konfirmuar së
8 Çështjes 10 dhe Aktakuzës së Konfirmimit të Çështjes 11 në
9 pritje të një kërkesë për të ndryshuar një akuzë për kërcënim,
10 sipas Pikës 3, të Aktakuzës së Konfirmuar të Çështjes 10 për
11 z. Januzi dhe z. Bahtijari.

12 Me 27 shkurt 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar
13 dorëzoi një kërkesë për ndryshimin e Aktakuzës së Konfirmuar
14 për Çështjen 10. Zyra e Prokurorit të Specializuar kërkoi një
15 ndryshim që kishte të bënte për shtimin për të dy, z. Januzi
16 dhe z. Bahtijari, "premtimin për një dhuratë ose një formë
17 tjetër përfitimi" për sa i takon kërcënimit gjatë procedurës
18 penale sikurse parashikohet në nenin 387 të Kodit Penal të
19 2019 të Kosovës dhe pretendimeve faktike në mbështetje të saj.

20 Më 17 maj 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendosi
21 që ndryshimi i kërkuar nga ZPS-ja përbënte një akuzë të re dhe
22 vërejtji që ai kishte të bënte vetëm me z. Januzi dhe z.
23 Bahtijari, sepse e njëjta akuzë ishte konfirmuar kundër z.
24 Shala. Gjykatësi i Procedurës Paraprake ftoi Mbrojtjen e z.
25 Januzi, dhe Mbrojtjen e z. Bahtijari që të bënin parashtrimet

1 e tyre lidhur me këtë ndryshim.

2 Më 8 korrik 2024, pas caktimit të kësaj çështjeje, unë
3 nxora vendimin për konfirmimin e ndryshimeve të aktakuzave dhe
4 çështje lidhur me to, në të cilën unë konfirmova ndryshimin.

5 Për më tepër, unë urdhërova Zyrën e Prokurorit të
6 Specializuar që të dorëzonte deri me 10 korrik 2024 një
7 aktakuzë të përbashkët kundër tri bashkëakuzuarve në këtë
8 çështje.

9 Së fundi, por jo nga rëndësia unë mblodha -- vendosa për
10 paraqitjen si të z. Januzi dhe z. Bahtijari në përputhje me
11 rregullën 90, paragraf 3 dhe 92 të Rregullores.

12 Më 10 korrik 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar
13 dorëzoi aktakuzën e përbashkët.

14 Sa i takon paraqitjeve të mëtejshme të ditës së sotme, më
15 lejoni që ta bëj të qartë atë për z. Januzi dhe z. Bahtijari.

16 Sikurse e dini seanca e ditës së sotme nuk është proces
17 gjyqësor, pra nuk është gjykim, sepse provat as nuk do të
18 paraqiten dhe nuk do të debatohen. Gjithashtu, dëshiroj që të
19 theksoj që nuk do të diskutohet për fajësinë ose pafajësinë e
20 të akuzuarve dhe nuk do të vendoset lidhur me të. Qëllimi i
21 paraqitjeve të mëtejshme parashikohet nga rregulli i 39 i
22 Ligjit, dhe rregullat 90 dhe 92 të Rregullores, në pajtim me
23 të cilën, secili prej të akuzuarve: Kanë një akuzë të re në
24 aktakuzën e përbashkët që ju lexohet të akuzuarve; konfirmon
25 që të akuzuarit e kuptojnë këtë akuzë të re; duhet të bindem

1 vetë që të drejtat e të akuzuarve janë të respektuara; dhe
2 informoj të akuzuarit që brenda 30 ditëve të seancës së sotme,
3 do bëhet një thirrje -- do të bëhet një seancë tjetër për sa i
4 takon akuzës së re dhe pranimin e fajësisë dhe të pafajësisë
5 prej tyre. Megjithatë, në qoftë se ndonjë prej të akuzuarve
6 dëshiroj që ta bëjë sot këtë gjë, ata mund ta bëjnë menjëherë
7 deklaratën e tyre për fajësinë ose pafajësinë lidhur me akuzat
8 përkatëse.

9 Z. Januzi dhe z. Bahtijari përpara sesa Sekretarja të
10 lexojë Akuzën e Konfirmuar të re kundër jush, dëshiroj që t'ju
11 kujtoj që kjo nuk është momenti që ju të kundërshtoni akuzën e
12 re, por thjesht qëllimi kryesor është, domethënë, që ju t'ju
13 bëhet me dije që është shtuar një akuzë e re.

14 Z. Januzi, a mund t'ju kërkoj që të konfirmoni, mund të
15 konfirmoni ju lutem që e keni marrë aktakuzën e përbashkët që
16 mban datën 10 korrik 2024, në një gjuhë që ju e kuptoni dhe që
17 e flisni, domethënë që e keni marrë versionin në shqip? Do ju
18 kërkoja të ngriheshit në këmbë dhe do të doja t'ju kërkoja që
19 ta konfirmoni që e keni marrë aktakuzën e përbashkët, z.
20 Januzi.

21 I AKUZUARI JANUZI: Po, e nderuara Gjykatëse, e kam
22 pranuar në ditën e djeshme

23 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit.

24 Tani do i kërkoj Sekretares së seancës që të lexojë
25 aktakuzën e re kundër jush siç parashikohet në nenin 39 të

1 Ligjit dhe rregullën 92. Siç parashikohet në aktakuzën e
2 ndryshuar.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
4 Gjykatëse.

5 Në aktakuzën e përbashkët Prokurori i Specializuar shton
6 akuzën e mëposhtme kundër Sabit Januzit.

7 Pika 3: Frikësim gjatë procedurës penale përmes premtimit
8 për një dhuratë ose formë tjetër përftimi, përkatësisht duke
9 ofruar ndihmë për Dëshmitarin 1 në qoftë se ai do të pajtohej
10 me tërheqjen e dëshmisë së tij në procedurat përpara Dhomave
11 të Specializuara, që është e dënueshme sipas parashikimit të
12 nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019 dhe nenit
13 15, paragrafi 2 i Ligjit.

14 Kjo vepër është kryer ndërmjet 5 dhe 12 prillit të vitit
15 2023.

16 Në lidhje me këtë vepër ekziston dyshimi i bazuar mirë që
17 z. Sabit Januzi mban përgjegjësi penale në pajtim me nenin 16,
18 paragrafi 3 i Ligjit, për:

19 a. Kryerjen e kësaj vepre nën Pikën 4 [Sipas
20 përkthimit], në pajtim me nenin 17 të Kodit Penal të Kosovës
21 të vitit 2019;

22 b. Bashkëkryerjen së bashku me z. Ismet Bahtijari dhe
23 z. Haxhi Shala të kësaj vepre sipas Pikës 3, në pajtim me
24 nenin 34 [Sipas përkthimit] të Kodit Penal të Kosovës të vitit
25 2018 -- 2019;

1 c. Për ndihmën për kryerjen e kësaj veprë, në Pikën 3,
2 në pajtim me nenin 33 të Kodit Penal të Kosovës të 2019;
3 dhe/ose

4 d. Për pajtim për të kryer së bashku me z. Ismet
5 Bahtijari dhe z. Haxhi Shala këtë veprë sipas Pikës 3, në
6 pajtim me nenin 35 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019.

7 Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

8 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit. Z. Januzi,
9 a e kuptoni akuzën që është ngritur, akuzën e re që është
10 ngritur kundër jush në aktakuzën e ndryshuar sikurse sapo ju
11 lexua nga Sekretarja e seancës? A e kuptoni këtë z. Januzi?

12 I AKUZUARI JANUZI: Po, e kuptoj.

13 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Januzi,
14 mund të uleni.

15 Z. Bahtijari --

16 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Kam ngritur
17 dorën, nuk e di në qoftë se mund të bëj një parashtrim të
18 shkurtër përpara se të flisni me z. Bahtijari. A është e
19 mundur

20 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Po ndoshta do të ishte
21 mirë që të lexojmë së pari akuzën, akuzat kundër klientit tuaj
22 dhe pastaj mund t'ja u jap fjalën juve.

23 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Do të ishte
24 mirë që ta merrja unë përpara fjalën sepse ka lidhje me atë
25 çfarë do e pyesni klientin tim.

1 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull.

2 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Klienti im
3 nuk e ka marrë aktakuzën në formë të printuar, fizike, sepse
4 ka vështirësi me sistemin përkatës. Megjithatë, ai e ka
5 ndryshimin, domethënë, ndryshimi i aktakuzës i është shpjeguar
6 prej meje. Me fjalë të tjera, ai nuk e ka marrë fizikisht
7 aktakuzën e ndryshuar, megjithatë i është shpjeguar përmbajtja
8 e akuzës së re dhe e aktakuzës së ndryshuar, në përgjithësi
9 prej meje.

10 Shpresoj që kjo t'ju vijë në ndihmë.

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull.

12 Zyra Administrative, doni që të bëni ndonjë konstatim
13 lidhur me këtë?

14 Z. NILSSON: [Përkthim] Z. Bahtijari e ka marrë aktakuzën
15 dje, dje pasdite. Ndoshta pasi ka folur me avokaten dhe mbase
16 kjo është arsyeja ose shpjegimi i situatës që na bëri të qartë
17 avokatja.

18 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Në rregull.

19 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit,
20 z. Zëvendësadministrator.

21 Z. Bahtijari, a mund të konfirmoni se e keni marrë
22 aktakuzën e re? Ju është bërë e ditur akuza e re?

23 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po, znj. Gjykatëse

24 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] E keni marrë në një gjuhë
25 që e kuptoni dhe e flisni, z. Bahtijari? Domethënë e keni

1 marrë në shqip? Është kështu?

2 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po, po, në shqip.

3 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z.

4 Bahtijari. Tani do i kërkoj Sekretares që të lexojë edhe

5 akuzën e re kundër jush, siç parashikohet në nenin 39 të

6 Ligjit dhe në rregullën 92 të Rregullores.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në aktakuzën e

8 përbashkët, Prokurori i Specializuar shton aktakuzën e

9 mëposhtme kundër z. Ismet Bahtijari.

10 Pika 3: Frikësim gjatë procedurës penale përmes premtimit

11 të një dhurate ose forme tjetër përftimi, përkatësisht përmes

12 ofrimit të ndihmës për Dëshmitarin 1 në qoftë se ai pajtohej

13 për tërheqjen e dëshmisë së tij në procedurat përpara Dhomave

14 të Specializuara, vepër kjo që është e dënueshme sipas nenit

15 387 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019 dhe nenit 15,

16 paragrafi 2 i Ligjit.

17 Kjo vepër është kryer ndërmjet 5 dhe 12 prillit të vitit

18 2023.

19 Në lidhje me këtë vepër ekziston dyshimi i mirëbazuar se

20 z. Ismet Bahtijari mban përgjegjësi penale në pajtim me nenin

21 16(3) të Ligjit, për:

22 a. Bashkëkryerjen së bashku me z. Sabit Januzi dhe z.

23 Haxhi Shala këtë vepër nën Pikën 3, në pajtim me nenin 31 të

24 Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019;

25 b. Ndhimimin për kryerjen e kësaj vepre nën Pikën 3, në

1 pajtim 33 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019; dhe/ose

2 c. Pajtimin për të kryer së bashku me z. Sabit Januzi
3 dhe Haxhi Shalën këtë vepër në Pikën 3, në pajtim me nenin 35
4 të Kodit Penal të Kosovës të 2019;

5 Faleminderit, e nderuar Gjykatëse

6 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, znj.

7 Sekretare.

8 Z. Bahtijari, a e kuptoni këtë akuzë të re që sapo jua
9 lexoi Sekretarja e seancës?

10 I AKUZUARI BAHTIJARI: Po

11 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z.

12 Bahtijari. Tani mund të uleni.

13 Z. Januzi dhe z. Bahtijari, të drejtat tuaja kryesore siç
14 garantohen nga ligji për Dhomat e Specializuara të Kosovës,
15 dhe Rregullorja e Procedurës dhe e Evidencave, ju janë lexuar
16 gjatë paraqitjes së parë me 9 tetor 2023. Megjithatë, më
17 lejoni që t'ju rikujtoj disa prej tyre.

18 Së pari, ju prezumoheni të pafajshëm derisa të
19 konstatohet se jeni të fajshëm përtej dyshimit të arsyeshëm.

20 Në përcaktimin e aktakuzave të ngritura kundër jush, keni
21 të drejtën që t'i nënshtroheni një procesi të drejtë ligjor.

22 Keni të drejtë që të informoheni menjëherë dhe në hollësi
23 në një gjuhë që ju e kuptoni lidhur me natyrën dhe shkakun e
24 akuza të ngritura kundër jush.

25 Keni të drejtë që të keni kohë të mjaftueshme dhe mjete

1 të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe që të
2 komunikoni me avokatin e zgjedhur prej jush.

3 Ju keni të drejtën që të gjykoheni brenda një kohe të
4 arsyeshme.

5 Keni të drejtën që të gjykoheni në praninë tuaj, dhe të
6 mbronit veten përmes avokatëve Mbrojtës. Dhe për procesverbal
7 them që ju jeni të përfaqësuar përkatësisht secili nga
8 avokatët tuaj mbrojtës.

9 Po ashtu, keni të drejtën për të pasur ndihmën pa pagesë
10 të një përkthyesi në qoftë se nuk e kuptoni gjuhën që flitet
11 në Gjykatë.

12 Keni të drejtën që të mos detyroheni që të dëshmoni
13 kundër vetes tuaj ose për të pranuar fajësinë.

14 Keni të drejtën që të qëndroni të heshtur, dhe nga
15 heshtja juaj nuk do të nxirret asnjë pasojë negative ndaj
16 jush.

17 Keni të drejtën që të dorëzoni mocione paraprahe lidhur
18 me akuzën e re që është shtuar në aktakuzën e ndryshuar.

19 Keni të drejtën që të merrni materialin mbështetës që
20 lidhet me aktakuzën e ndryshuar që është dorëzuar për
21 konfirmim.

22 Keni të drejtën që të mos ndaloheni për një periudhë të
23 paarsyeshme përpara hapjes së çështjes. Të kërkonit rishikimin
24 e vendimeve, të vendimit tuaj dhe të apeloni vendime të tilla
25 përpara Gjykatës së Apelit.

1 Keni të drejtën që të apeloni ose në mënyrë të
2 drejtpërdrejtë ose procesit të certifikimit siç parashikohet
3 në rregullore.

4 Tani do i jap mundësinë të akuzuarve që të shprehen
5 lidhur me fajësinë ose pafajësinë e tyre, në pajtim me
6 rregullën 92.

7 Z. Januzi, ju drejtohem ju pikësëpari. A mund të çoheni
8 në këmbë, ju lutem.

9 Brenda 30 ditëve nga dita e sotme, juve do t'ju kërkohet
10 që të shpreheni me fajësinë ose pafajësinë lidhur me këtë
11 akuzë të re që është përfshirë në aktakuzën e përbashkët. Në
12 qoftë se dëshironi mund të shpreheni që tani sa i takon
13 fajësisë ose pafajësisë tuaj.

14 Për këtë arsye dua t'ju kërktoj tani, z. Januzi në qoftë
15 se keni pasur mundësi që këtë akuzë të re e keni diskutuar apo
16 jo me avokatin tuaj, dhe në qoftë se jeni përgatitur për të
17 thënë në qoftë se jeni fajtor apo jofajtor lidhur me këtë
18 akuzë.

19 I AKUZUARI JANUZI: Po, e kam përgatitur me avokatin, dhe
20 unë dua të bëj deklarimin që tani.

21 Pra, siç jam deklaruar në seancën e parë se në të gjitha
22 pikat e aktakuzës jam i pafajshëm, deklaroj se edhe në këtë
23 ndryshim aktakuzë jam plotësisht i pafajshëm

24 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z. Januzi.
25 Faleminderit, z. Januzi. Mund të uleni tani.

1 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] E nderuar
2 Gjykatëse, a mund t'ju ndërpres edhe një herë përpara se t'i
3 drejtoheni z. Bahtijari.

4 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Fjala është për ju.

5 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
6 Faleminderit.

7 Z. Bahtijari besoj se do të japë të njëjtën përgjigje. Do
8 të deklarohej i pafajshëm, por ai ka nevojë, prandaj ndërpres
9 unë herë pas here të garantohem që ta kuptojë z. Bahtijari që
10 ky është momenti që ai duhet të vetëdeklarohej i pafajshëm.
11 Faleminderit.

12 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, Avokates.

13 Po në fakt unë tani do i drejtohesha z. Bahtijari. Z.
14 Bahtijari, mund të çoheni në këmbë.

15 Dhe ju z. Bahtijari keni mundësinë të vetëdeklarohej
16 tani nëse dëshironi në bazë të Rregullores, rregulla 92. Nëse
17 nuk dëshironi mund ta bëni për 30 ditë këtë. Nëse dëshironi
18 mund ta thoni që tani, mund të vetëdeklarohej i fajshëm ose
19 pafajshëm.

20 Prandaj z. Bahtijari, a keni pasur mundësi ju të
21 diskutoni me avokaten tuaj, dhe a doni të vetëdeklarohej
22 tani? Ju e dëgjuat çfarë tha edhe avokatja juaj. Besoj se keni
23 folur paraprakisht, megjithatë po ju jap të drejtën të flisni.
24 Fjala është për ju.

25 I AKUZUARI BAHTIJARI: Unë deklaroheja i pafajshëm në të

1 gjitha.

2 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Faleminderit, z.
3 Bahtijari, mund të uleni.

4 Në rregull atëherë. Tani u lutem palëve nëse kanë ndonjë
5 aspekt tjetër që duan të trajtojnë, por që lidhet me seancën e
6 sotme për z. Januzi dhe z. Bahtijari. Kanë ndonjë gjë palët që
7 duan të shtrojnë sot?

8 Z. BOWDEN: [Përkthim] Sa i takon programit, planifikimit
9 më saktë, për mocionet paraprake është kjo diçka që doni ta
10 trajtojmë sot sa i takon datës së dosjes paraprake apo është
11 diçka që ta diskutojmë më vonë?

12 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Keni diçka për dosjen
13 paraprake?

14 Z. BOWDEN: [Përkthim] Po. Ju keni thënë dhe keni bërë një
15 ndryshim të vendimit që ishte fillimisht në pezull dhe pastaj
16 u lëshua. Ne mendojmë që do bëjmë kundërshtime për aktakuzën
17 dhe ne mendojmë që është mirë që dosja paraprake të dorëzohet
18 shtatë ditë pas vendimit të formës së prerë që do të merret me
19 mocionin paraprak.

20 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në fakt afati fillestar
21 ka qenë 15 korrik, 7 ditë pasi keni marrë njoftimin për
22 ndryshimin e akuzës. Në fakt afati është dhënë me kërkesë të
23 z. Januzi, ky afat. Konkretisht çfarë kërkon?

24 Z. BOWDEN: [Përkthim] Po e them këtë sepse ne fillimisht
25 nuk e dinim se si do të ishte aktakuza përfundimtare dhe, e

1 nderuar Gjykatëse, ju u pajtuat dhe thatë do të merret një
2 vendim për këtë.

3 Ka disa data që janë dhënë për mocionet paraprake por
4 këto data ndikojnë edhe dosjen tonë përfundimtare. Kështu që
5 deri në momentin që do të merret vendimi i formës së prerë për
6 aktakuzën, pra, të presim vendimet përkatëse që do të merren
7 për mocionet tona, ne mendojmë që është më mirë, e ka logjikë,
8 që dosjen paraprake ta dorëzojmë pasi të merren vendimet
9 përfundimtare nga ana juaj.

10 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Konkretisht po kërkon
11 shtyrje të afatit?

12 Z. BOWDEN: [Nuk ka përkthim]

13 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Po mund ta kishit thënë
14 me fjalë të thjeshta.

15 Z. BOWDEN: [Përkthim] Po, do ta dorëzojmë dosjen
16 paraprake, por në -- pasi të jenë marrë vendimet përfundimtare
17 lidhur me mocionet paraprake që do të bëjmë ne. Dhe propozojmë
18 që të bëhet shtatë ditë pasi të merret vendimi përfundimtar
19 nga ana juaj lidhur me aktakuzën.

20 Sigurisht që kjo nuk do të krijojë asnjë vonesë të
21 fillimit të gjykimit apo të kalimit të çështjes gjyqësore duke
22 patur parasysh fazën ku jemi, edhe sigurisht edhe faktin që do
23 të fillojnë pushimet e Gjykatës shumë shpejt. Ne jemi në duart
24 tuaj, e nderuar Gjykatëse, sa i takon vendimeve që do të
25 merrni, por mendojmë që do të duam rreth 28 ditë që të

1 dorëzojmë dosjen përfundimtare.

2 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Ju, avokatja Xherri
3 [Sipas përkthimit] keni ndonjë parashtrim në lidhje me këtë?

4 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Unë po
5 prisja në fakt radhën time, pasi të mbaronit me z. Bowen.

6 I drejtohem Prokurorisë, keni ndonjë gjë për të thënë
7 lidhur me këtë kërkesë?

8 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Jo. Prokuroria nuk ka ndonjë
9 kundërshtim lidhur me këtë kërkesë.

10 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Atëherë unë po ju
11 propozoj kështu, ose më saktë po ju kërkoj të bëni një
12 parashtrim me shkrim lidhur me këtë çështje dhe do marrim
13 vendimin në kohën e duhur.

14 Z. BOWDEN: [Përkthim] Faleminderit, patjetër.

15 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Ju, avokatja Xherri
16 [Sipas përkthimit], kishit dhe ju për të thënë diçka?

17 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Jo, në fakt.
18 Z. Bahtijari ka një takim me familjen sot, takon nipin e ri
19 sot, e porsalindur, sot, kështu që duam që të përfundojmë sa
20 më shpejt kjo që z. Bahtijari të ketë mundësi të shohë nipin,
21 dhe parashtrimet që do të kemi do t'i dorëzojmë me shkrim.

22 Ka ndonjë parashtrim tjetër prej palëve? Jo.

23 Mirë. Përpara se ta mbyllim seancën e sotme, po ju jap
24 datën për dorëzimin e mocioneve paraprake lidhur me akuzën e
25 re që është shtuar në aktakuzë. Fillimisht ka qenë 19 korrik,

1 e premte 2024. Unë do i kërkoja Mbrojtjes së z. Januzi dhe
2 Mbrojtjes së z. Bahtijari nëse do t'i dorëzojnë mocionet
3 paraprahe me këtë -- lidhur me këtë akuzë të re?

4 Z. BOWDEN: [Përkthim] Në emër të z. Januzi, po.

5 ZNJ. GERRY: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Në emër të
6 z. Bahtijari, nuk e kemi vendosur ende. Të shohim njëherë
7 çfarë parashtrimesh do të ketë z. Januzi dhe pastaj do të
8 vendosim.

9 GJYKATËSJA MASSELOT: [Përkthim] Në rregull. Kjo mund të
10 ketë ndikim në datën për kalimin e çështje gjyqësore, prandaj
11 datën përfundimtare për kalimin e çështjes do ta japim në një
12 moment të mëvonshëm.

13 Okej, me kaq mbyllim seancën. Falënderoj palët, Zyrën
14 Administrative. Faleminderit përkthyesve, stenografit, të
15 gjithë personave të sigurisë që na ndihmuam.

16 Seanca mbyllet këtu. Ju faleminderit.

17 --- Seanca e Paraqitjes së Mëtejshme mbyllet në
18 orën 09.59

19

20

21

22

23

24

25